

## Letër Pozicionimi

### **Për garantimin e pjesëmarrjes së publikut në fushën e mjedisit**

**Kjo letër pozicionimi i është drejtuar** Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si dhe, **për dijeni:** Komisionit Parlamentar për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen e Mjedisit; Këshillit të Ministrave; Sekretariatit të Konventës së Aarhusit; Delegacionit të BE-së në Tiranë.

Organizatat Jofitimprurëse Mjedisore në Shqipëri konstatojnë mangesi lidhur me procesin e Pjesëmarrjes së Publikut në Vendimmarrje. Me anë të këtij dokumenti OJF-të përpiqen të sjellin rekomandime për përmirësimin e kësaj situate dhe për zbatimin e detyrimeve që lindin nga Konventa e Aarhusit<sup>1</sup>.

Në takimin e Dhjetorit 2006<sup>2</sup> të OJF-ve mjedisore u identifikua, si përparësi e sektorit, kërkesa për plotësimin sa më parë të kuadrit ligjor me aktet nënligjore, për të garantuar të drejtat e publikut në vendimmarrje, transparencën dhe gatishmërinë e institucioneve qeveritare për të dhënë informacion për publikun e gjerë.

Në vijim të kësaj nisme OJF-të, më dhjetor 2008, mandatuan një grup pune të përbërë nga specialistë të fushës, të cilët, të lehtësuar nga Milieukontakt, kanë formuluar këtë dokument.

Letra e pozicionimit do të shërbejë edhe si platformë veprimi për hartimin e fushatave të OJF-ve mjedisore që synojnë rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, mundësimin e informacionit dhe qasjen në organet e drejtësisë për çështje mjedisore.

### **Situata Aktuale**

Institucionet shtetërore në Shqipëri përgjithësisht janë angazhuar që të zbatojnë legjislacionin mjedisor dhe Konventën e Aarhusit në veçanti.

Megjithëse kemi një legjislacion përgjithësisht të mirë mjedisor për informimin e publikut dhe për pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje, në mjaft raste ai nuk është respektuar nga institucionet shtetërore.

---

<sup>1</sup> Shqipëria e ka nënshkruar më 1998

<sup>2</sup> Takimi i 6-të Kombëtar i shoqatave mjedisore Shqiptare

Qëndrimet shpesh jotransparente të Ministrisë së Mjedisit, ARM-ve në rrethe si dhe mungesa e tërheqjes së mendimit të publikut në çështjet mjedisore, veçanërisht gjatë studimeve të vlerësimeve të ndikimit në mjedis të projekteve të rëndësishme, tregojnë se publiku shqiptar ende nuk është bërë pjesë e vendimmarrjes.

## **Analiza e Situatës**

1. *Për sa i përket Legjislacionit*, Legjislacioni për Mbrojtjen e Mjedisit ka mungesa të rëndësishme në aktet nënligjore, si dhe jo gjithmonë ka vullnet për të zbatuar legjislacionin ekzistues.
2. *Për sa i përket informimit të publikut*, ky proces në mjaft raste ka qenë dhe vazhdon të jetë formal, jo në kohën e duhur dhe jo sipas detyrimeve të parashikuara në aktet nënligjore. Në shumicën e rasteve projektet e mëdha fillojnë të zbatohen pa tërhequr mendimin e komunitetit të banorëve të zonës ose duke injoruar kundërshtimet e ndryshme.
3. *Për sa i përket përfshirjes së publikut në vendimmarrje*, ende nuk ka një organ konsultativ apo vendimarrës në fushën e mjedisit, i cili të ketë përfaqësues të OJF-ve mjedisore me të drejta të plota, ndonëse shoqëria civile ka pasur përvoja pozitive në këtë fushë.
4. *Për sa u përket kompetencave mjedisore të pushtetit vendor*, rezulton se nuk janë të qarta dhe shpesh herë kanë shkaktuar konflikte me organet qendrore dhe pasoja mjedisore. Gjithashtu pushteti vendor shpesh nuk ka zbatuar detyrimet ligjore për përfshirjen e publikut në vendimmarrje mjedisore.
5. *Për sa u përket organeve ndërministrore*, rezulton se organe, si: Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Ujërave nuk kanë respektuar legjislacionin apo strategjitë kombëtare, duke sjellë shpesh pasoja në mjedis.
6. *Për sa i përket bashkëpunimit me OJF-të mjedisore*, rezulton se, megjithë angazhimin e madh të këtyre organizatave, ka munguar mbështetja e duhur financiare nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave apo institucione të tjera shtetërore.

## **Konkluzione dhe Rekomandime**

Faktet e mësipërme tregojnë që, krahas përmirësimit të legjislacionit, duhet të ndryshojë edhe mentaliteti i ligjvënësve shqiptarë, duke respektuar procesin e vendimmarrjes nga poshtë-lart.

Duke u bazuar në analizën e mësipërme ne rekomandojmë:

- Të plotësohet sa më parë kuadri ligjor, *veçanërisht duke miratuar aktet nënligjore mjedisore*, që do të bënin të zbatueshëm në praktikë si legjislacionin vendas, ashtu dhe aktet ndërkombëtare të miratuara nga vendi ynë. Gjithashtu t'i kushtohet vëmendje e veçantë zbatimit të legjislacionit mjedisor.
- Të zbatohen mekanizmat e informimit për t'i dhënë publikut informacionin e plotë në një kohë reale.
- Të parashikohet përfshirja në organet vendimmarrëse (me të gjitha të drejtat, pra, duke përfshirë edhe të drejtën e votës) të përfaqësuesve të publikut (OJF-ve në fushën e mjedisit). Është e nevojshme që qeveria t'i bëjë të vetat përvojat pozitive të projekteve të shoqërisë civile dhe të rritë bashkëpunimin në procesin e vendimmarrjes lidhur me mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit dhe planifikimin hapësinor.
- Të krijohet një fond i veçantë për mbështetjen e OJF-ve mjedisore.

Për gjithë sa më sipër, ne shpresojmë që ky dokument të jetë një kontribut në përmirësimin e klimës së dialogut dhe të bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe qeverisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Grupi i punës për Pjesëmarrjen Publike

Përfaqësuesit e organizatave jofitimprurëse